



Tiranë më 20.04.2020

Drejtuar: *Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë*
Institucioneve të Arsimit të Lartë publik në Shqipëri

Përgatitur nga: *Unioni i Këshillave Studentorë*

Letër e hapur

Duke marrë shkas nga gjendja jo e zakonshme në të cilën ndodhet vendi ynë në sajë të masave për mbrojtjen ndaj përhapjes pandemike të COVID-19, të prekur ndjeshëm janë dhe studentët, të cilët përveç një gjendje të rënduar psikologjike, ndër të tjera po përballen me shumë vështirësi në ndjekjen e procesit të zhvillimit të mësimit online. Në adresën e Unionit të Këshillave Studentorë kanë ardhur vazhdimisht shqetësime nga studentët, dhe ne përmes kësaj letre të hapur kërkojmë të ndajmë me ju shqetësimin kryesor, atë të lidhur me aspektin financiar. Është e kuptueshme se studentët janë prekur ndjeshëm financiarisht gjatë këtij semestri të vitit akademik, ndaj duke marrë në konsideratë që:

- Familjet shqiptare po përballen me një situatë të vështirë ekonomike, për shkak të masave të ndërmarra për përballimin e pandemisë së COVID-19, ndikim ky i drejtpërdrejtë në financat e studentëve, si pjesë e këtyre familjeve të prekura;
- Dhe për më tepër që studentët po marrin minimumin e shërbimeve nga Universiteti për semestrin e dytë të këtij viti akademik (procesi i zhvillimit të mësimit vetëm online dhe jo i plotë), situatë kjo që e minimizon koston e operimit të universitetit.

Vleresojmë të arsyeshme që të kërkojmë nga ana Juaj,

- Përgjysmimin e detyrimeve të tarifave të shkollimit për të gjithë studentët për vitin akademik 2019-2020;
- Përgjysmimin e detyrimeve të strehimit për studentët të cilët jetojnë në konvikte.

Masat lehtësuese financiare të kërkuara më lart nuk mbulojnë efektin e krijuar nga kjo gjendje, por zbusin efektet e saj tek studentët dhe janë në raport të drejtë me shërbimet e marra prej tyre.

Duke i konsideruar të rëndësishme këto kërkesa, presim nga ana juaj jo lëmosh por urojmë mos të na lini kurrë vetëm, sidomos kur kemi të drejtë!

Sinqerisht,
Studentët Tuaj